



**Zoran Stanković**, ka lindur më 09 nëntor 1954, në fshatin Tegovishtë, komuna e Vlladiçin Hanit, është gjeneralmajor i mjekësisë në pension. Stankovići ka qenë ministër i shëndetësisë dhe i mbrojtjes në Qeverinë e Republikës së Serbisë dhe ministër i mbrojtjes i Serbisë dhe Malit të Zi si dhe kryeshef i Akademisë Mjekësore Ushtarake (VMA). Stankovići ka qenë edhe ministër i mbrojtjes në Këshillin e Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi deri në shpërbërjen e unionit shtetëror. Është zgjedhur si më i miri prej mjekëve më të ri në përbërjen e shërbimit mjekësor të JNA-së (Armata Popullore Jugosllave), oficeri më i mirë i shërbimit mjekësor, ndërsa tri herë radhazi ka marrë grada më të larta, gradën e majorit, nënkolonelit dhe të gjeneralmajorit mjekësor.

Shkollën fillore e kreu në Cepë, gjimnazin në Vlladiçin Han, ndërsa Fakultetin e Mjekësisë në Nish në vitin 1980. Mbas mbarimit të shërbimit ushtarak, ka kryer Shkollën e Oficerëve Rezervist dhe kështu duke u bërë pjesë aktive në shërbimin ushtarak. Pas mbarimit të praksës së domosdoshme mjekësore në Spitalin Ushtarak të Nishit, është transformuar në Pejë, ku prej vitit 1982 deri 1985 mbajti postin e administratorit në garnizonin spitalor. Menjëherë pas caktimit në atë pozitë u gradua si togër i shërbimit mjekësor, më pas është zgjedhur si më i miri prej mjekëve të ri në përbërjen e shërbimit mjekësor të JNA-së (Armatës Popullore Jugosllave).

Studimet postdiplomike nga fusha e mjekësisë ligjore i kreu në vitin 1988 në VMA (Akademia Mjekësore Ushtarake), ndërsa pas mbarimit të specializimit është caktuar në postin e mjekut

të mjekësisë ligjore në Institutin për Mjekësi Ligjore të VMA-së (Akademia Mjekësore Ushtarake). Si mjek i mjekësisë ligjore ka kryer ekspertiza mjeko-ligjore për gjykatat ushtarake dhe civile, ndërsa në dy herë edhe në Gjykatën e Lartë në Selanik. Nga fundi i vitit 1991 deri 1997. Ka kryer autopsinë e më shumë se 5000 viktimave në luftërat në hapësirat e ish Jugosllavisë. Ka qenë anëtar dhe kryetar i Komitetit Jugosllav për mbledhjen e të dhënurave rreth shkeljeve të drejtave ndërkombëtare humanitare Qeverisë RFJ-së. Prej vitit 1992 nga ana e Kombeve të Bashkuara, bashkë me 11 ekspertë tjerë, dhe si i vetmi nga ish Jugosllavia, është caktuar për ti kryer autopsitë e të rënëve në konfliktet e armatosura në këto vende. Nga ana e kryeshefit të Shtabit të Përgjithshëm është zgjedhur si oficeri më i mirë i shërbimit mjekësor për vitin 1993.

Të dhënat nga të gjeturat e autopsisë, më vonë i kanë shërbyer për përpunimin e disertacionit të doktoraturës të cilën e ka mbrojtur në vitin 1997. Po në të njejtin vit në bazë të materialeve të mbledhura ka propozuar që të themelohet ekipi për hulumtimin e pasojave të bombardimit të NATO-s në territorin e Republikës Serbe. Në të kaluarën shumë herë kishte ofruar ndihmën eksperte Gjykatës së Hagës.

Gradën e gjeneralmajorit të mjekësisë e morri në vitin 2001. Detyrën e kryeshefit të Institutit për Mjekësi Ligjore dhe Departamentit të patologjisë dhe mjekësisë ligjore të VMA-së (Akademisë Mjekësore Ushtarake) e ka kryer deri në vitin 2002, kur është emëruar për kryeshef të këtij institucioni. Në këtë pozitë qëndroi deri në vitin 2005.

Kuvendi i Unionit të shteteve të Serbisë dhe Malit të Zi, në vitin 2005 e ka zgjedhur ministër të mbrojtjes dhe anëtar të Këshillit të Ministrave. Pozitën e ministrit të mbrojtjes e mbajti edhe pas shpërbërjes së Serbisë dhe Malit të Zi, ndërsa në këtë pozitë qëndroi deri në vitin 2007, kur pas zgjedhjeve është konstituuar qeveria e re e Republikës së Serbisë. Në vitin 2011 bëhet ministër i shëndetësisë në Qeverinë e rekonstruktuar të Serbisë.

Morri pjesë në shkrimin e shumë librave, ka botuar më shumë se pesëdhjetë punime shkencore dhe profesionale, ka qenë bashkëpuntor në krijimin e disa filmave dokumentar dhe ekspozitave muzeale. Rreth viktimave të luftërave ka mbajtur ligjerata në Kembrixh, Londër, Pariz, Hagë, Utreht, Amsterdam, Kijevë, si dhe në parlamentin e Britanisë së Madhe dhe parlamentin e Ukrainës.

Është i martuar me Marinën, me të cilën ka dy vajza binjake, Ivën dhe Inën.